



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 40.2 nën c) të LVL nr.03/L-040 dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në raste urgjente me rastin e Pandemis-Coronavirusit, si dhe nenit 30 të Ligjit nr.03/L-148 mbi menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjesit, nenin 15 të ligjit nr.07/L-001 Mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 Udhëzimit Administrativ MF-05/2019 Për procedurat e transferit dhe rialokimit dhe sipas Qarkores Ligjore Për zbatimin e vendimeve të Qeverisë Për Parandalimin e Virusit COVID-19 dhe me kërkesen e Kryesuesit të Kuvendit dhe Kryetarit të Komunës së Klinës me datën 25.03.2020 ku thirret Seancë Urgjente e Kuvendit të Komunës së Klinës e cila seancë mbahet në formë elektronike me datën 27.03.2020 gjërë në orën 15:00, me paraqitjen Pro të 26 anëtareve të Kuvendit për marrjen e ketij:

V E N D I M I

Për

Ndarjen dhe transferin e mjeteve në shumë prej 50,000.00€ për parandalimin e virusit COVID-19

I

Miratohët vendimi për ndarjen dhe transferin e mjeteve në shumë prej 50,000.00€ për parandalimin e Virusit COVID-19, nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale në kategorinë mallra dhe shërbime fondi burimor 10.

II

Nga Programi Planifikimi urban dhe mjedisi (660), nen-programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), kodi funksional (0620) nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale-Projekti Bashkëfinancim me donatorë ,kodi 48267 shuma 50,000.00 €

Në programin Shërbimet Publike Mbrojtja Civile (180) nën-programi (18018), kodi funksional (0451) në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, kodi ekonomik 13460-Shërbime kontraktuese tjera.

III

Ndarja e këtyre mjeteve kërkohet bazuar në nevojat e menaxhimit të gjendjes emergjente në Komunën e Klinës për shpenzimet lidhur me përballimin e kërkesave që dalin lidhur me përballjen me pasojat e Virusit Korona-COVID-19 dhe me qëllim të marrjes se masave të domosdoshme për luftimin e këtij virusi dhe pasojave të tij në komunën e Klinës.

IV

Vendimi ekzekutohet nga Drejtorija e Financave, Ekonomi dhe Zhvillim në kordinim me Ministrinë e Financave dhe Kryetarin e Komunës.

V

Vendimi është i plotëfuqishem me miratim nga Kuvendi i Komunës dhe 7 ditë pas publikimit në çeb faqe të Komunës konform Rregullores (QRK) nr.10/2019 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (shtojca II).

Me këtë vendim të njftohën: MAPL, MF, Kryetari i Komunës, Drejtorija e Financave, Ekonomi dhe Zhvillim, Sherbimi për Punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr./zyrtar /2020
Klinë, me dt.27.03./2020

